



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:1	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	28.04.2022 Ora: 10:00
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimana
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar;7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimet Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. Tog. Xhevahir Hasanaj, nga FSK;16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendinela Shatri, EVSB;19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS"; dhe24. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.
	<p>Mungojnë: Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike; Jerej Nebojsa Sekulić, Kisha ortodokse;</p>

	<p>Enver Boletini, KLSP-Gurakoc; Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë; Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim</p> <p>Pjesëmarrës tjerë: Jeta Balaj, Zëdhënëse e Komunës Istog; Mehmed Qeman, përkthyes; Blerim Gerguri, përkthyes Mensur Haziri, FSK; Bahrije Muqa, OSCE; Abedin Lataj, UNMIK; Jaong Kleme, KFOR;</p>
<p style="text-align: center;">Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Rendit të ditës, 2. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK 3. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.) 4. Miratimi i Planit të Punës për vitin 2022 5. Të ndryshme 	

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Përshëndet të gjithë të pranishmit, anëtarët e KKSB-së, në veçanti i pershendes Antarët e ri të KKSB-Së dhe kerkoj që bashkarisht të jemi aktiv me qellimin e ngritjes së nivelit të siguris në gjith teritorin e Komunës Prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve dhe pyet a ka propozime për ndryshim të rëndit të ditës.

Pasi që diskutime nuk pat:

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës – vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policisë.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog – Para se të filloj me prezencimin Komandanti u prezentua për antarët e ri të KKSB-së të cilet mund të mos e kani

njoftur. Gjendja në zonën e përgjegjesisë së stacionit Istog është e qetë, stabile dhe e qendrueshme. Deri në periudhën që raportoj në stacionin e Policisë kemi pas të paraqitura gjithsej 190 raste, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku kemi pas 172 raste, dmth këtë vit i kemi 18 raste më shumë.

Zbulueshmeria e rasteve këtë vit është më e mirë dhe sillet tek 70% të rasteve në përgjithësi, poashtu edhe zbulueshmeria e rasteve penale është më e mirë se vitin e kaluar.

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pas të arrestuar 97 persona, nga ta të ndaluar kemi pas 35 persona, kemi konfiskuar 14 copë armë të kalibrave të ndryshëm dhe kemi asistuar në 13 raste të gjitha agjencioneve që kanë të drejtë asistime dhe kanë kërkuar nga ne.

Rast pak ma senzitiv kemi pas me 26.03.2022 në Suhogërll një grabitje e armatosur, janë zhvilluhetime të shpejta dhe të dyshuarit janë arrestuar, rasti është duke u procedu nga njësitë i hetimeve rajonale. Më lejoni të paraqes disa shqetsime të qytetarve që janë paraqit në stacionin e Policisë, si shqetsimi nga qent endacak, kërkoj nga K.Komunal shenjzimin me shenja komunikacioni e sidomos zebrat ku jeni deshmitar se tani më janë fshi dhe nuk vrehen asnjë. Kemi bashkpunim të mirë me drejtorin për parandalimin e nderimeve pa leje, gjithashtu ju informoj se Policia është në zbatim të Planit Operativ "Stop Drogave në Shkollë" ku kemi të angazhuar zyrtar Policor edhe në rroba civile gjat gjithë orarit të punës respektivisht orarit të Shkollave. Poashtu një kërkesë për Kryetarin e Komunes që ka të bëjë me parkingun apo deponin e druve të konfiskuara nga prerjet ilegale të cilat dergohen për rruajtje deri në zhvillimin e procedurave të plota rreth tyre dhe të njëjtat në mungesë roje dhe kamerave jo funksionale serish vidhen, andaj kërkoj që të ket persona përgjegjës 7x24 dh kamera funksionale 7x24.

Me që është takimi i parë i KKSB bëra një paraqitje duke bërë edhe krahasime në pika dhe jamë i gatshëm për përgjigjet tuaja nëse ka.

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës -Falenderon Kap. Enver Gashi dhe hapë debatin për antar të KKSB-së.

Zeqir Mehmetaj, RTV " Fontana"- Komandant kërkoj falje nuk e di a e paraqitet informacionin e mbramshe të sulmit ndaj Policisë tek stacioni i autobusve. Ndoshta edhe më ka ikur por nuk e vreja këtë informacion.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policisë Istog - Rreth orës 17.30 min. Patrolla zyrtare në detyrë në afërsi të stacionit të autobusve është sulmuar nga disa persona. Janë arrestuar 4 persona, me urdher të Prokurorit ju është caktuar masa e ndalimit për 48 orë. Rasti kalon për hetim të mëtutjeshëm dhe procesim nga njësitë i hetimeve rajonale.

Zenun Bujupaj, përfaqësues i komunitetit Shqipëtar - I nderuari Komandant a ka mundësi që për herat tjera rastet të jenë të kategorizuara si psh rasti i Syrigores, e kam fjalën këto 190 rastet a do të kishin mundësi të kategorizohen, pra për mbledhjet tjera e kam fjalën.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog – Do filloj nga

- aksidentet e trafikut kemi pas rritje, në vitin 2022 i kemi pas 26 raste, ndersa 2021, 22 raste gjithnjë krahasimet janë për tremujorin e parë,
- aksidente me lendime, në vitin 2022 i kemi pas 8 raste, ndersa 2021, 6 raste,
- Aksidente me dëme materiale, në vitin 2022 i kemi pas 18 raste, ndersa 2021, 16 raste,
- Persona të lënduar në aksidente, në vitin 2022 i kemi pas 13 raste, ndersa 2021, 7 raste,
- Tiketa të shqiptuara në trafik, në vitin 2022 i kemi pas 1770 gjoba, ndersa 2021, 368 gjoba dmth ka rritje 381%,
- Lendime të rënda trupore këtë vit nuk kemi vitin e kaluar një rast,
- Lendim i lehtë trupor, vitin 2022 19 raste,
- Vjedhje 16 raste per tremujorin e parë
- Vjedhje të rana 9 raste
- Dhunë në familje, vitin 2022 11 raste ndersa vitin 2021 16 raste,

Zenun Bujupaj, perfaqses i komunitetit Shqipëtar – Falenderoj komandantin dhe kerkon falje per kohen, kam edhe një pyetje raste të pa zbuluara e që janë me interes ma të veçant a keni.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog – Po kemi disa raste të viedhjeve të rana që ende nuk i kemi zbulu. Jemi në fazen e hetimeve optimale dhe shfrytzoj rastin që tju bëj thirrje gjithë qytetarve për perkrahe të Policis me qellim të parandalimt dhe arrestimit të kryersve të veprave penale.

Zenun Bujupaj, perfaqses i komunitetit Shqipëtar – Pikrisht viedhjet janë shqetsimi qytetarve andaj edhe e bëra pyetjen.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog – Edhe ma heret e paraqita kete rast ka qen vetem një rast i grabitjes dhe aj është zbulu dhe ka të arrestuar. Në pergjithësi për të gjitha rastet zbulueshmeria vitin 2022 është 70.5% ndersa vitin 2021 ka qen 69.5%.

Zeqir Mehmetaj, RTV “ Fontana”- Komandant per mua ishte pak sa konfuze deklarata e para disa ditëve e Policis për dy nxans të arrestum në Gjinnazin “Haxhi Zeka” Istog ku tek njëni u gjet një sasi e vogel narkotikësh. Komunikata ishte Policia e Pejes konfiskon drog në Istog.

Rasti tjetër është i para dy ditve perleshja në fsh. Tomoc rreth një prone.

Një ndeshje ka ndodh mbrëm por nese kthehem ma mbrapa ka ndodh edhe ma heret në Rr. Bajram Gashi që shpije në drejtim të Vrellës, a ka mundsi për vendosje të pengesave rrugore apo shtimit të patrollave policore sepse nga ura e troftes e gjer te Nora market së fundmi ka tejet shumë aksidente.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog – Sa i perket rastit së nxënësve të Shkolles “Haxhi Zeka”, Njësitit antidrog nga Peja ka qën me detyr në Istog, dhe ata e kan krye arrestimin dhe procesimin e lëndes, ndersa stacioni jonë vetëm ka asistu në rastin.

Rasti në fsh. Tomoc besoj se ju jeni në dijeni ka ndodh prishje e rendit publik dy persona jan grushtu mes veti dhe si pasoj njani asht arrestu dhe me urdher të Prokurorit është mbajt në ndalim në st. Policor të Istogut.

Sa i perket pengesave në rrugë dhe gjitha shenjave tëkomunikacionit unë e kamë paraqit një kerkes Kryetarit të Komunes të hartuar nga një grup i zyrtarve të Policis në bashkëpunim me zyrtar komunal të komunikacionit dhe problemi është i adresuar tek institucioni kompetent.

Pra edhe një her po e potencoj se kemi zyrtar Policor nga Istogu por edhe nga Peja në uniform dhe rroba civile të angazhuar në PO “stop drogave”.

Robert Gegaj, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunes- Tek siguriya në Shkolla, më intereson a ka të gjetura më të mëdha apo është rasti i vetëm i Gjimnazit, gjithashtu një kontroll rutinore që është organizu në Shkolla a ka qën e organizuar nga Policia apo nga institucionet shkollore me që ka pas gjetje edhe të armve të zjarrit dhe armve të ftofta, kamë informacione por nuk kam informacione zyrtare.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog – Edhe një her e potencoj se zyrtarët policor janë prezent në afersi të shkollave pothuajse gjatë gjithë kohës dhe kemi pas raste të konfiskimit të armve ku Policia ka intervenu pas informimit nga Drejtoria e Shkollës në Gurakoc për armë të ftofta dhe Policia ka vepru konform Ligjit i ka sjell fëmijt në stacion dhe me urdhër të Prokurorit rasti është procedu. Kemi pas edhe disa raste tjera si aj në Shkollën e Banjës dhe rasti është procesu nga policia e Istogut.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Për informimin tuaj Komandant dhe antarve të KKS-së sa i perket shenjave të komunikacionit vitin 2021 është hapur tenderi dhe ka pas ankesa nga operatori ekonomik i ranguar si i dyti dhe me që Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka korum për vendim marrje lënda është ende e pa kryer dhe Drejtorati nuk ka pas mundsi të procesoj më tutje me lëndën pa u krye çeshtja e ankeses, shpresoj që sa më shpejt të kompletohet OSHP-ja dhe të kemi mundsin të procesojm ma tutje këtë çeshtje.

Çeshtja tjetër qe do të duhej të jetë shqetsuese është fakti se për tre mujorin e këtij viti kemi një rritje të tiketave prej 381% por që në anën tjetër kemi edhe rritje të aksidenteve me dëme materiale dhe lendime trupore. Mendoj se MPB-ja, gjegjësisht Policia e Kosovës do të duhej të bëj një analiz të këtyre statistikave, çfar rezultatesh po jepin. Më lejoni të bëj një krahasim me që udhtoj për Mal të Zi, atje për një koh të shkurt gjobat në trafik kanë dhën rezultate dhe tani sa her udhtoj unë i vrej gjithë pjesmarrsit që respektojn rregullat e trafikut dhe aksidentet janë reduktuar dukshëm.

Ka raste kur policia duke u nisur nga gjendja ekonomike në Kosovë reduktojnë lartsin e denimit në trafik por që ky fakt nuk jep rezultate, sidomos tek kategoria e vozitësve me mosh më të re.

Si pasojë e mos rrespektimit të rregullave të trafikut përditë e më shumë kemi kërkesa për vendosje të pengesave horizontale në trafik. Pretendojmë të hyjmë në Europë por gjithandëj nuk shëndrrohen rruget si tek ne, ku është levizja e lirë e pjesës që rrespektojnë rregullat e trafikut. Që njëzet vite jamë pjesë e e forumeve të sigurisë në nivel lokal dhe qëndror. Ka pasur organizime nga niveli qëndror, OSBE dhe UNDP por asnjëherë nuk është bërë një analizë më detajë e këtyre çështjeve që publiku të jetë i informuar.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - E theksova edhe më heret se ka probleme të shenjzimit në trafik, si psh zebrat në gjithë zonën e pergjegjësisë nuk shihen fare. Kemi pas aksident me fatalitet në Bellopoj, kemi paraqit kërkesë urgjente tek Kryetari i komunës, me që në atë pjesë kemi pas disa herë aksidente dhe është bërë një zgjidhje emergjente aty me një staf nga Komuna dhe Policia. Shpresoj se së shpejti të kryhet procedura e tenderimit dhe të zgjidhet problemi i shenjzimit në trafik.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderoj Komandantin e Policis për raport të detajuar dhe për faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate. Në emër të Komunës zotohem se gjitha shqetsimet që u ngritën nga Ju do të adresohen sikur se edhe rasti tek udhëkryqi në fsh. Bellopoj ku është bërë një zgjidhje e perkohëshme për parandalimin e shumë aksidenteve që kanë ndodhë në atë udhëkryq. Me Ministrin e Ifrastruktures jemi në koordinim për gjetjen e zgjidhjes afatëgjatë. Si institucion relevant të gjitha shqetsimet e ngritura për siguri në komunikacion do të adresohen dhe në bashkëpunim me zyrtarët profesional të gjindet zgjidhja.

Me që nuk ka më diskutues lidhur me këtë pikë kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - fton perfaqësuesit e institucioneve sipas radhëtjes kush ka të prezentojë.

Rrsh. Berat Babaj, perfaqësues i FSK-së- Jemi ekip i ri që e Perfaqësojmë FSK-në në Istog dhe zonën e pergjegjësisë, në mungesë të N/togerit Albert Rexhepi, sot e perfaqësoj unë. Bataloni i dytë ka bashkëpunim të mirë me Komunën dhe Policinë dhe për aktivitetet e FSK-së jashtë kazerme gjithnjë i informojmë këto dy institucione, ani pse ushtrimet i bëjmë jashtë zonave urbane megjithatë me kohë i informojmë për aktivitetin e radhës.

Naim Behtulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim-Sigurinë në shkollë fal bashkëpunimit me Policinë çdo ditë në vijim vrehen përmasimet. Më lejoni të veçoj

dy raste dhe atë; Shkolla "Trepça" në Banjë ku një prind ka sulmuar një nxëns dhe fal Policis rasti është procesu në organe kompetente për zgjidhje. Rsti tjetër në Shkollën " Marrtin Camaj" Gurakoc ku dy femij jan gervisht mes veti , Policia ka nderhy dhe rasti është zgjidh. Në Shkollat tjera situata është stabile, fal DKA-së, Drejtorve të Shkollave dhe Policisë. Duhet pak kohë për zgjidhjen e disa dukurive negative si ato të perdorimit të narkotikve që na shqetson shumë por do ta arrijm bashkarisht.

Robert Gegaj, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunes- pyetje për Drejtorin e DKA-së, shpreh shqetsimin e në ëmër të prindve për mungesat e shumta të mësimëdhënsve në Shkolla. A ka statistika në Drejtori të Shkollave apo në DKA pse ndosh kjo, sepse kjo gjendje krijon pa siguri në shkolla me që nxënsit ose dalin neper lokale ose edukat fizike, nese nuk keni sotkëto të dhëna atëher na i prezentoni në takimin e radhes.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim- Çdo muaj mbajm takime të rregullta me Drejtorët e Shkollave ku raportohet për probleme duke përfshi edhe mungesat e nxënësve dhe mësimëdhënësve. Në momentin që pensionohet mësimdhënsi procedura e perzgjedhjes i merr dy muej kohë edhe pse tentojm të zgjedhim me zavendsime por po krijohen probleme me mungesa të shumta nga nxënsit dhe nga mësimdhënsit. Mungesat tjera kanë qen me arsye apo pa arsye por ndikim ka pas edhe gjëndja e pandemis ku kemi pas edhe mësimdhënës dhe nxënës të prekur nga COVID-19.

Zenun Bujupaj, perfaqses i komunitetit Shqipëtar - Mungesat kur mësimëdhënsi pensionohet për mu janë të pa pranueshme. Saktësisht dihet dita kurë del në pension andaj procedurat duhet zhvillu paraprakisht dhe kjo gjendje të permirsohet. Jamë plak në Arsim por qetash pe di që kjo qënka problem.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim- Tash kemi fillu me sistematizim sepse jemi duke marr listen nga qershori deri në fund të vitit kush del në pension dhe të fillojm me procedura. Problemin më të madhin e kemi me mësimëdhënës të cilët kanë probleme shëndetsore si të bëhet zavendsimi i tyre. Pra kemi hartu një strategji për zavendsimin e mësimdhënësve të pensionuar.

4. Miratimi i Planit të Punës për vitin 2022

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës - Draft planin e punës e keni marrë me kohë nga koordinatori i KKSb-së dhe besoj se e keni analizuar. Hapi debatin nese ka dikush për të shtuar diçka.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Në bashkëpunim me Kryetarin dhe me Komandantin e Policisë kemi hartuar një draft Planë të punës dhe mendojm se i kemi përfshi çeshtjet që janë me randsi për KKSb-në. Gjatë punës së KKSb-së ju

si antar do të keni mundsin edhe në pikën të ndryshme të ngrisni ndonjë shqetsim i cili kërkon debat dhe propozime për zgjidhje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës – Me që nuk ka propozime pyes antarët të deklarohen kush është për këtë Planë të punës. Antarët unanimisht u deklaruan për miratimin e Planit të Punës për vitin 2022.

5. Të ndryshme.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Sa i perket temes Monitorimi i Këshillave në të gjitha Shkollat propozoj që të formojm një komision i cili do të monitoroj Shkollat dhe do të hartoj një raport për KKSB-në. Në Komision duhet të jenë Drejtori i DKA-së apo i emruari i tijë, Kryetari i këshillit të Prindve, perfaqsesja e EVSB-së, nga Policia pergjegjsi i sektorit ku gjindet Shkolla dhe perfaqsesi i komunitetit pakic ku ka nxënës të komuniteteve.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës –

Pasi që diskutime tjera nuk ka, faleminderit për pjesmarrje dhe për angazhimin tuaj dhe shihemi në takimin e radhës.
